

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA SH.A

PROCESVERBAL PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE PËR MOSNDARJEN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT NË LOTE

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Hartim Projekti për ndërtimin e dallgëthyesit dhe bankines jugore dhe thellimit të vendbazimit detar Pashaliman Vlorë”

FONDI LIMIT: 22,706,754.43 (njëzet e dy milion e shtatëqind e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër pikë dyzet e tre) **lekë pa TVSH.**

Kjo vlerë konvertohet në 246,384.05 euro. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më 02/09/2026 është 92.16 lekë.

Procedurë e Hapur Shërbim Mbi Kufirin e Lartë Monetar

I mbajtur sot në datë 23.07.2026 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt “Hartim Projekti për ndërtimin e dallgëthyesit dhe bankines jugore dhe thellimit të vendbazimit detar Pashaliman Vlorë”.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

- 1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*
- 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.*

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote sepse: natyra e objektit të prokurimit është e njëjtë.

Ndarja në lote për këtë objekt prokurimi nuk ruan funksionalitetin dhe qëllimin e kontratës për arsye se fazat e kryerjes së shërbimit janë të lidhura ngushtësisht me njëra tjetrën dhe ndarja e këtyre fazave në Lote ndikon në mos realizimin e shërbimit nëse njëri nga lotet dështon.

Nga ana tjetër, referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar neni 2 prashikohet shprehimisht se:

“Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar neni 14, dhe neni 88 i VKM nr.285/2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar njeh gjithashtu të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Akoma më tej, legjislacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojën për kontratë noteriale por vetëm paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarqe të ndryshme.

Mos ndarja në lote e procedurës së prokurimit, nuk e kufizon tregun, pasi kriteret e hartuara në DST janë gjithëpërfshirëse, që u jepet hapësirë dhe mundësi të gjithë operatorëve ekonomik të interesuar për tu bërë pjesë e procedurës të sipërcituar.